



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.775/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Afijete Sada-Gllogjani kryesuese, Adnan Konushevci dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës Leona Barbatovci nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Fushë Kosovës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.775/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga Leona Barbatovci, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, dega në Fushë Kosovë.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 03.11.2021 me të cilën ka pretenduar se në qendrën e votimit në Vragoli, vendvotimi 0912E/01R dyshon se i janë mohuar votat si kandidate për asamble komunale.

Apelit i ka bashkangjitur raportin e vëzhguesit të LDK-së në atë vendvotim si dhe FRP-në.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se apeli i parashtruar nga Leona Barbatovci, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, më të cilën ka kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret Paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidaten e këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesja, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritet e ankueses për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankueses nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Leona Barbatovci, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.775/2021 më datën 05.11.2021**

**Kryesuesja e Panelit
Afijete Sada Glllogjani**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.